

Bazuar në nenin 11 të Udhëzimit Administrativ – Aktivitetet jashtëshkollore nr. 02/2016 të dt. 12.01.2016, vendimin me nr. 212 të datës:17.01.2025 nga KDSH, drejtoria e gjinnazit "Gjon Buzuku" në Prizren, shpall:

Ftesë për ofertë

Për ekskursion të maturanëve të gjinnazit "Gjon Buzuku" në Prizren

Ftojme ofertuesit e kualifikuar (Agjencitë turistike organizatorë të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarf të mbyllur, për ekskursionin e maturanëve të gjinnazit "Gjon Buzuku" nga Prizreni për në Republikën e Shqipërisë më datën **06.05.2025** deri më **10.05.2025**.

Paraqitësit në tender duhet t'i plotësojnë këto kushte:

Kriteret e përgjithshme

- Të jetë i licensuar (licenca e agjencisë turistike)
- Certifikata e agjencionit transportues
- Të ketë bërë kontrollin teknik sipas procedurave ligjore,
- Fotokopjet e librezave të autobusëve që janë të regjistruar sipas procedurave ligjore,
- Certifikata e autobusit sipas licencës D
- Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës mbi 340 vende
- Autobusët të jenë komforë dhe me klimë,
- Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusit
- Agjencioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënësit dhe dëshmi, certifikatë pune me diplomë të mjekut që shoqëron nxënësit.
- Dëshmi për rezervimin e hotelit për datat 06.05.2025 deri më 10.05.2025.
- Agjencioni turistik duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve.
- Certifikatat e shoferëve (CPC)
- Referencat rreth organizimit të ekskursionit për tri vite të fundit,
- Certifikatën e biznesit me informata për biznesin,
- Vërtetim për pagesën e tatimit në pronë
- Agjensioni të ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar nga banka për tre vitet e fundit (2022, 2023 dhe 2024) së paku 300 000 euro.
- Të prezantohet ambienti (komoditeti) së paku me foto i Hotelit nr.telefonit i pronarit dhe adresa të përcaktuar nga KDSH.
- Hoteli të posedojë mbi 340 shtretër. Të posedojë rrethojë dhe i siguruar nga personeli i sigurimit të hotelit për të garantuar siguri për nxënës. Gjithashtu hoteli të posedoj banjo dhe ujë të mjaftueshëm përcaktuar nga KDSH.
- Hoteli të posedojë sallën e ushqimit me hapsirë të mjaftueshme mbi 340 vende për ushqim në tri vaktet kriter i përcaktuar nga KDSH.
- Hoteli të posedojë sallë për argëtim për nxënës dhe të mos shërbehet apo lejojë shitjen dhe përdorimin e pijeve alkoolike në tërë hapësirën e hotelit KDSH
- Sistemimi i nxënësve në dhoma të jetë jo më shumë se katër nxënës përcaktuar nga KDSH.
- Të prezantohet mënyja e ushqimit dhe pijeve për tri racione ditore për pesë ditë qëndrimi KDSH
- Gjatë vizitave nëpër monumente të sigurohet shujta dhe pagesa hyrëse nëpër monumente nga kompania sipas itinerarit kriter i KDSH.
- Agjencioni duhet të ofrojë listën e shoferëve dhe punëtorëve që do të marrin pjesë në ekskursion kriter i KDSH.
- Agjencioni të ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar nga banka për tre vitet e fundit, kriter i KDSH
- Oferta për nxënësit të liruar nga pagesa KDSH

Vërejtje- Kompania Turistike fituese në përfundim të ekskursionit duhet të siguroj nënshkrime nga Drejtoresha e shkollës, përfaqësuesi i Këshillit të prindërve, përfaqësuesi i këshillit të nxënësve për përmbushjen e kushteve të përcaktuara sipas kriterëve të lartëcekura dhe ky document të dorëzohet në DKA.

P.s. Lartësia e pagesës 145 euro

Ofertuesit e interesuar aplikacionet dhe itinerarin e udhëtimeve mund t'i marrin në administratën e shkollës dhe të kompletuara me dokumentacionin e kërkuar të dorëzohen në Drejtorinë Komunale të Arsimit në Prizren.

Afati i paraqitjes në tender është 7 ditë. Hapjen e ofertave e bëjnë komisioni sipas UA 02/2016 me datë 24.02.2025, **në ora 17:00** në ambientet e DKA Prizren ku mund të marrin pjesë edhe ofertuesit.

Pas hapjes së ofertave, komisioni do të verifikojë dokumentacionin dhe kushtet e ofruara nga kompanitë, ku dhe do të bëhet vlerësimi.

Drejtoria e shkollës mban të drejtën për anulimin e ofertës.